

VENDIM
Nr. 67, datë 28.1.2015

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, AMBASADËS SË REPUBLIKËS
POPULLORE TË KINËS, NË TIRANË, TË NJË PJESE TË PASURISË “OFIÇINA E
AUTOMJETEVE, TIRANË”, ZONA KADASTRALE NR. 8250, TIRANË, NË
ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 901 e vijues, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim, pa shpërblim, Ambasadës së Republikës Popullore të Kinës, në Tiranë, të një pjese të pasurisë “Ofiçina e automjeteve, Tiranë”, zona kadastrale nr. 8250, Tiranë, ndërtesë së bashku me truallin funksional prej 9 000 m², sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi, pasuri në administrim të Ministrisë së Punëve të Jashtme, për përdorimin e saj nga kjo ambasadë, në përputhje me termat e marrëveshjes së reciprocitetit, të nënshkruar, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës.

2. Ambasadës së Republikës Popullore të Kinës, në Tiranë, i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për kryerjen dhe ndjekjen e procedurave ligjore të shpronësimit publik, të pronarëve të truallit që preken nga zbatimi i këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe kryeregjistruesi i Zyrës për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama


PLANVENDOSJE



Shk: 1:1000

ZK 8250

Indeksi Hartes: TR;Q-8
TR;R-8

9000 m²





Legjenda

— Kufiri Prones

